



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

Përmbledhja e Aktgjykimit

(Vetëm për median. Nuk është dokument zyrtar)

D H O M A T

Hagë, 26 shkurt 2009.

Përmbledhje e aktgjykimit në çështjen Prokurori kundër Milutinoviçit dhe të tjerëve

Më poshte vijon përmbledhja e aktgjykimit shqiptuar sot prej Gjykatësit Bonomy:

Dhoma Gjyqësore është mbledhur sot për shpalljen e vendimit në procesin gjyqësor Prokurori kundër Milan Millutinoviçit, Nikolla Shainoviçit, Dragolub Ojdaniçit, Nebojsja Pavkoviçit, Vladimir Llazareviçit dhe Sreten Llukviçit. Do të lexoj përmbledhjen e përfundimeve të Dhomës nga Aktgjykimi. Gjithsesi versioni autoritativ ndodhet në Aktgjykimin e shkruar, që do të jetë në disponim në përfundim të kësaj seance.

Në fillim, Dhoma dëshiron t'u shprehë mirënjohjen e saj avokatëve, punonjësve të Sekretarisë, përkthyesve, stenografëve gjyqësorë dhe të gjithë të tjerëve që kanë ndihmuar në ecurinë e duhur dhe efikase të këtij procesi.

Aktgjykimi është një dokument i gjatë, i cili pasqyron madhësinë dhe kompleksitetin e këtij procesi gjyqësor. Procesi gjyqësor filloi më 10 korrik 2006 dhe përfundoi më 27 gusht 2008. Gjatë kësaj kohe, Dhoma dëgjoi dëshminë gojore gjithsej të 235 dëshmitarëve dhe pranoi më shumë se 4300 prova materiale.

Gjatësia e procesit, vëllimi i provave dhe madhësia e Aktgjykimit janë kryesisht pasojë e numrit dhe të natyrës së akuzave në Aktakuzë. Të Akuzuarit ngarkohen me çdo formë përgjegjësie të përcaktuar në Nenet 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit për rolin e pretenduar të tyre në krime që thuhet se u kryen në Kosovë mes 1 janarit dhe 20 qershorit 1999 nga forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së Serbisë, të cilësuarat më tej si forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Konkretisht pretendohet se të Akuzuarit janë përgjegjës për: dëbim, krim kundër njerëzimit (pika 1); transferim të dhunshëm si "veprime të tjera çnjerëzore," krim kundër njerëzimit (pika 2); vrasje, krim kundër njerëzimit dhe shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës (pikat 3 dhe 4); dhe përndjekje, krim kundër njerëzimit (pika 5). Sipas Aktakuzës, të Akuzuarit morën pjesë, bashkë me të tjerë, në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për të ndryshuar raportin etnik të Kosovës, për garantimin e vazhdimësisë së kontrollit të krahinës prej autoriteteve të RFJ-së dhe të Serbisë. Më tej Prokuroria pretendon se qëllimi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale do të arrihej me anë të një fushate të gjerë ose sistematike terrori dhe dhune kundër popullatës shqiptare të Kosovës, përfshirë krime të ndryshme konkrete të përmendura në çdo pikë të Aktakuzës.

Në pikën 1, Aktakuza përshkruan se si u realizua dëbimi i shqiptarëve të Kosovës në fillim të vitit 1999 nga 13 komunat anembanë Kosovës dhe në veçanti nga qytetet dhe fshatrat e atyre komunave. Duhet theksuar se përshkrimet në fjalë përmbajnë të dhëna mbi vrasje, shkatërrimin e pronës, UJedhje, sulme seksuale, rrahje dhe forma të tjera të dhunës që, sipas Prokurorisë, ndihmuan në krijimin e një atmosfere frike dhe shtypjeje nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë për të lehtësuar dëbimin e popullatës shqiptare të Kosovës. Në pikat 3 dhe 4, pretendohet se u krye një sërë vrasjesh në vende të ndryshme të Kosovës. Së fundi, në pikën 5, Aktakuza pretendon se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë zbatuan një fushatë përndjekjesh kundër popullatës shqiptare të Kosovës, përfshirë këtu

Internet address: <http://www.un.org/icty>

Media Office/Communications Service

Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands

Tel.: +31-70-512-5343; 512-5356 Fax: +31-70-512-5355

vrasje, sulme seksuale dhe shkatërrim pa cak apo dëmtim të objekteve fetare. Mirëpo, veprime konkrete të dëbimit dhe të transferimit të dhunshëm të përshkruara në pikat 1 dhe 2 nuk përfshihen në pikën 5 si forma të përndjekjes, siç iu bëri të ditur Dhoma palëve gjatë procesit.

Në kohën e krimeve të pretenduara, Milan Millutinoviçi ishte Presidenti i Republikës së Serbisë; Nikolla Shajnoviçi ishte Zëvendëskryeministri i Republikës Federale të Jugosllavisë, apo të RFJ-së; Dragolub Ojdaniçi ishte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, apo të UJ-së; Nebojsa Pavkoviçi ishte Komandanti i Armatës së Tretë të UJ-së; Vladimir Llazareviçi ishte Komandanti i Korpusit të Prishtinës të UJ-së; dhe Sreten Llukiqi ishte Shefi i Shtabit të Ministrisë së Brendshme të Serbisë për Kosovën, i njohur këtu si shtabi i MPB-it. Aktakuza pretendon se sëcili i Akuzuari mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe, në këto role, ata ushtruan autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi forcat e UJ-së dhe të MPB-së të përfshira në kryerjen e krimeve të pretenduara. Thuhet gjithashtu se planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo ndryshe ndihmuan dhe inkurajuan në këto krime.

Pas konferencës parajyqësore të mbajtur më 7 korrik 2006, Dhoma lëshoi një urdhër sipas Rregullës 73 bis të Rregullores së Procedurës dhe të Provave që nuk e lejoi Prokurorinë të paraqiste prova lidhur me tri vende krimi të pretenduara në Aktakuzë. Në fund të Aktgjykimit, palët urdhërohen të bëjnë parashtrime të duhura me shkrim, brenda dy javeve, se si të procedohet në lidhje me këto akuza.

Aktgjykimi ndahet në katër vëllime. Vëllimi i parë trajton ligjin përkatës në këtë çështje dhe me përfundimet e Dhomës për strukturat politike dhe kushtetuese të RFJ-së dhe të Serbisë, konfliktin e armatosur që është tema e Aktakuzës dhe forcat e ndryshme të përfshira në atë, si dhe përpjekjet diplomatike për zgjidhjen e konfliktit. Në vëllimin e dytë, Dhoma parashtron përfundimet e saj në lidhje me krimet që thuhet se u kryen në Kosovë mes marsit dhe qershorit 1999 nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Në vëllimin e tretë, Dhoma paraqet përfundimet lidhur me përgjegjësinë individuale penale të të gjashtë të Akuzuarve. Vëllimi i katërt përmban shtojcat e Aktgjykimit, përfshirë një analizë të provave lidhur me më shumë se 800 viktima të vrarë dhe të përmendur me emër në Listat e Aktakuzës.

Do të filloj me përfundimet e Dhomës në lidhje me krimet që pretendohet se u kryen nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Theksoj se në Aktgjykim, Dhoma i jep toponimet e Kosovës në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. Mirëpo, gjatë leximit anglisht të kësaj përmbledhjeje do të jepen vetëm toponimet serbisht.

Dhoma përfundon se në fund të viteve 80 dhe gjatë viteve 90 në Kosovë ndodhi një krizë politike, e cila kulmoi në një konflikt të armatosur ku morën pjesë forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dhe forcat e UÇK-së, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që prej mesit të vitit 1998. Gjatë konfliktit të armatosur, ndodhën incidente ku UJ-ja dhe MBP-ja përdorën forcë të tepruar dhe pa cak me pasojë dëmtim të pronës civile, shpërngulje të popullatës dhe vrasje civilësh. Me gjithë përpjekjet për përfundimin e krizës, duke përfshirë ardhjen në Kosovë të një misioni ndërkombëtar verifikues, konflikti vazhdoi deri më 24 mars 1999 dhe përtej kësaj date kur forcat e NATO-s nisën një fushatë të bombardimit ajror kundër objektivave në RFJ-së. Kjo fushatë përfundoi më 10 qershor 1999 dhe forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u tërhoqën nga Kosova. Pjesë të Aktgjykimit analizojnë provat në lidhje me përpjekje të dukshme për negociata midis shqiptarëve të Kosovës dhe autoriteteve të RFJ-së dhe të Serbisë në vitet 1998 dhe 1999, me marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare të përfunduara në tetor 1998, me situatën që u zhvillua më vonë, si dhe me përfshirjen e bashkëbiseduesve ndërkombëtar për zgjidhjen e krizës, që si rezultat solli mbajtjen e konferencës në Rambuje të Francës në shkurt 1999.

Përgjithësisht, nuk kundërshtohet fakti se në Kosovë shumë njerëz braktisën shtëpitë e tyre gjatë bombardimit të NATO-s; dhe shumë prej tyre kaluan kufijtë me Shqipërinë dhe me Maqedoninë. Prova dokumentare dhe dëshmitarë, si të Prokurorisë, po ashtu edhe të Mbrojtjes, konfirmuan këtë lëvizje të shpejtë, kryesisht të shqiptarëve të Kosovës. Për shembull, një sërë raportesh nga Shtabi i MPB-së e dërguar Selisë së MPB-së në Beograd, nga 24 mars deri më 1 maj 1999, informojnë për numrin e shqiptarëve të Kosovës që kaluan kufijtë në atë periudhë. Sipas këtyre raporteve, në javën e parë të bombardimit të NATO-s, më shumë se 300,000 shqiptarë të Kosovës kaluan në Shqipëri ose në Maqedoni. Deri në 6 prill kjo shifër ishte dyfishuar, dhe deri më 1 maj numri kishte arritur 715,158.

Prokuroria pretendon se këta qindra mijëra shqiptarë të Kosovës ikën nga krahina për shkak të veprimeve të dhunshme dhe shtrënguese të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë të cilat ushtruan një fushatë terrori dhe të dhunës kundër popullatës shqiptare të Kosovës për t'i dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe për t'i detyruar të kalonin kufijtë. Ky pretendim u mbështet nga dëshmi përputhëse të shumë dëshmitarëve shqiptarë të Kosovës si dhe të disa ish-punonjesve të UJ-së dhe të MPB-së të cilët dëshmuar për Prokurorinë. Mirëpo dëshmitarë të Mbrojtjes mohuan në mënyrë të përsëritur se kishte patur dëbim të organizuar të shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre, dhe shumë prej tyre dhanë arsye të tjera për lëvizjen masive të shqiptarëve të Kosovës për në Shqipëri dhe Maqedoni, përfshirë bombardimin e NATO-s dhe veprimet e UÇK-së.

Dhoma Gjyqësore është në dijeni të faktit se në disa pjesë të Kosovës, si brenda 13 komunave të përmendura në këtë Aktgjykim po ashtu edhe gjetiu, njerëzit mund të jenë larguar nga shtëpitë e tyre për shkaqe të ndryshme, për shembull për shkak të udhëzimeve të UÇK-së, të dëshirës për të mos qëndruar në një zonë ku UÇK-ja dhe forcat e RFJ-së dhe të Serbisë zhvillonin luftime, ose për shkak se objektivat e bombardimit të NATO-s ndodheshin pranë vendbanimeve të tyre. Mirëpo, me gjithë argumentat e Mbrojtjes e cila pretendoi se këto ishin arsyet kryesore të lëvizjes masive të njerëzve brenda Kosovës dhe për në Shqipëri dhe Maqedoni, asnjë dëshmitar shqiptar i Kosovës nuk përmendi bombardimin e NATO-s si një ndër shkaqet e largimit të tij, dhe Dhoma përfundoi se vetëm në një zonë të komunës së Vushtrrisë dhe në një zonë tjetër të komunës së Suharekës, njerëzit ishin në lëvizje për shkak të veprimeve të UÇK-së. Dëshmitarë shqiptarë të Kosovës, të cilët dëshmuar për dëbimin e tyre dhe të shumë të tjerëve, vinin nga shtresa të ndryshme të këtij grupi etnik dhe zakonisht nuk kishin asgjë të përbashkët përveç viktimizimit të tyre, dhe është e pamundur që të gjithë ata të kenë sajuar rrëfimet e hollësishme dhe përputhëse të ngjarjeve që ata përjetuan dhe panë.

Për më tepër, bombat e NATO-s goditën objektiva kudo në RFJ. Sipas ish-komandantit të Forcave Ajrore dhe të Mbrojtjes Ajrore të UJ-së, shkatërrimi më i madh ishte në Beograd dhe, me gjithë këtë, njerëzit nuk u larguan nga Beogradi apo nga pjesët e tjera të RFJ-së në atë masë si në Kosovë. Rrjedhimisht, Dhoma përfundon se bombardimi i NATO-s nuk ishte shkak i shpërnguljes masive të shqiptarëve të Kosovës nga Kosova.

Megjithëse, në të njëjtën kohë me fushatën ajrore të NATO-s, kishte një konflikt të armatosur në vazhdim midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, Dhoma nuk beson se ky konflikt ishte shkak i ikjes së qindra mijëra shqiptarëve të Kosovës nga fundi i marsit deri në fillimin e qershorit 1999. Konflikti midis UÇK-së dhe UJ-së dhe MPB-së filloi në mesin e vitit 1998 dhe u intensifikua gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator të atij viti. Ndërsa shumë shqiptarë të Kosovës u shpërngulën në atë kohë, shumica e tyre mbetën brenda kufijve të Kosovës dhe nuk ndodhi asnjë lëvizje masive e njerëzve përtej kufijve si ajo që filloi më 24 mars 1999. Për më tepër, Dhoma kujton se, megjithëse UÇK-ja përbënte një forcë të dukshme në momente dhe në vende të ndryshme, ajo kishte pak njerëz në krahasim me trupat e UJ-së dhe të MPB-së të dislokuar në Kosovë nga marsi deri në qershor 1999, dhe nuk dispononte armatimin dhe pajimet e rënda të forcave të shtetit.

Dëshmitarë shqiptarë të Kosovës që dëshmuan për përvojën e tyre dhe të familjeve, miqve dhe fqinjëve të tyre gjatë javëve nga 24 marsi deri në fillim të qershorit 1999, treguan pak a shumë të njëjtën histori për frikën që sundoi në qytetet dhe fshatrat kudo në Kosovë, jo për shkak të bombardimit të NATO-s, por për shkak të veprimeve të UJ-së dhe të MPB-së dhe të forcave të tjera që i ndihmuan. Në të 13 komunat e përmendura në Aktakuzë si vende të dëbimit dhe të transferimit të dhunshëm, Dhoma përfundon se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dëbuan shqiptarët e Kosovës qëllimisht nga shtëpitë e tyre, qoftë duke i urdhëruan të iknin, qoftë duke krijuar një atmosferë terrori për të realizuar ikjen e tyre. Gjatë kohës që këta njerëz largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe ishin në lëvizje brenda Kosovës apo në drejtim të kufirit dhe duke kaluar kufirin, shumë prej tyre vazhduan të kërcënoheshin, të plaçkiteshin, të keqtrajtoheshin apo të keqpërdoreshin. Në shumë vende, burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët, makinat e tyre u vodhën apo u shkatërruan, shtëpitë e tyre u dogjën qëllimisht, u zhvatën të holla dhe u detyruan të dorëzonin dokumentat e tyre të identifikimit.

Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore përfundon se, gjatë kohës së bombardimit ajror të NATO-s, u ndërmor një fushatë e gjerë dhune kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës, nga forcat nën kontrollin e autoriteteve të RFJ-së dhe të Serbisë, gjatë të cilës ndodhën vrasje, sulme seksuale dhe shkatërrime të qëllimshme të xhamive. Ishin veprimet e qëllimshme të këtyre forcave gjatë kësaj fushate që shkaktuan ikjen e të paktën 700,000 shqiptarëve nga Kosova në periudhën e shkurtër midis fundit të marsit dhe fillimit të qershorit 1999. Përpjekjet e MPB-së për të fshehur vrasjen e shqiptarëve të Kosovës, duke transportuar kufomat në zonat e tjera të Serbisë, siç diskutohet hollësisht në Aktgjykim, sugjerojnë se vrasje të tilla ishin të natyrës kriminale.

Do të përmend shkurtimisht disa prej përfundimeve faktuale të Dhomës në lidhje me vendet e ndryshme të krimit. Në fund të marsit 1999, në qytetin e Pejës së Dukagjinit u krijua një atmosferë tepër e dhunshme dhe kërcënuese kur forcat policore dhe ushtarake po digjin shtëpi, po qëllonin me armë dhe po keqtrajtonin popullatën vendase shqiptare të Kosovës. Si pasojë, një numër i madh banorësh të qytetit ikën apo u urdhëruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Disa prej tyre u drejtuan për në Malin e Zi, kurse të tjerë për në qendrën e qytetit ku hipën në autobusa dhe u çuan në kufirin e Shqipërisë. Kur këta shqiptarë të Kosovës u kthyen në Pejë pas konfliktit, panë se shumë prej shtëpive të tyre ishin djegur, megjithëse shtëpitë e banorëve serbë të qytetit mbetën të padëmtuara.

Në komunën e Deçanit, në jug të Pejës, ndodhën incidente të ngjashme në fshatin Beleg në fund të marsit 1999. Banorët shqiptarë u grumbulluan nga policia dhe personeli i UJ-së, ku përfshiheshin edhe rezervistë dhe gjatë këtij incidenti u vranë disa burra. Një grup i madh i përbërë kryesisht nga gra dhe fëmijë shqiptarë të Kosovës u izoluan dhe u keqtrajtuat. Disa gra u sulmuan seksualisht dhe disa burra u keqtrajtuat fizikisht. Ditën e nesërme, shumica e njerëzve nga ky grup u urdhëruan të shkonin në Shqipëri, dhe prej atyre që mbetën aty nuk ka lajme që prej asaj kohe.

Në jug të Deçanit, në qytetin e Gjakovës, që prej fillimit të fushatës ajrore të NATO-s forcat e policisë dhe të UJ-së krijuan një atmosferë të përgjithshme terrori. Këto forca morën pjesë në plaçkitjet dhe djegiet e ndërtesave të caktuara, dhe forcat e MPB-së vranë banorë shqiptarë të qytetit, duke përfshirë një grup prej 20 grash dhe fëmijësh në një bodrum në Rrugën Millosh Giliq në fillim të prillit. Si pasojë, shumë shqiptarë ikën nga qyteti dhe kaluan kufirin e Shqipërisë. Gjatë rrugës, forcat e UJ-së dhe të MPB-së ua morën dokumentat identifikuese. Banorët shqiptarë të fshatrave të komunës së Gjakovës u dëbuan gjithaashtu nga shtëpitë e tyre nga forcat ushtarake dhe policore në prill 1999, në veçanti gjatë një operacioni të përbashkët në zonën e njohur si Lugina e Rekës apo Caragojës në fund të atij muaji. Gjatë atij operacioni, anëtarë të policisë dhe të UJ-së

vranë një numër shqiptarësh. Më vonë u gjetën kufomat e të paktën 287 të zhdukurve nga Meja dhe rrethinat në një varr masiv në Batajnicë, afër Beogradit.

Nuk kundërshtohet se UJ-ja dhe MPB-ja zhvilluan një operacion të gjerë në fund të marsit 1999 në një zonë që përfshin pjesë të komunave të Prizrenit, të Suharekës dhe të Rahovecit, në pjesën jugperëndimore të Kosovës. Gjatë atij operacioni, më 25 mars 1999, fshatarët shqiptarë të Piranës, komuna e Prizrenit, ikën nga shtëpitë e tyre si pasojë e granatimit të fshatit dhe të djegies së shtëpive nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së. Në të njëjtën ditë, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan fshatin Celinë në komunën e Rahovecit, duke plaçkitur dhe duke djegur shumicën e shtëpive. Këto forca terrorizuan banorët e fshatit, duke vrarë disa njerëz. Banorët e Celinës të cilët kishin ikur nga shtëpitë e tyre dhe ishin strehuar në një pyll aty afër u kapën dhe u morën sende me vlerë dhe dokumenta të identifikimit. Disa prej tyre u keqtrajtuuan fizikisht dhe ata u dërguan në drejtim të kufirit të Shqipërisë. Gjithashtu anëtarë të MPB-së shkatërruan qëllimisht xhaminë e atjeshme më 28 mars 1999, një ditë feste myslimane.

Në ditën kur u sulmuan Celina dhe Pirana, forcat e UJ-së dhe të MPB-se goditën edhe Bellacërkën në komunën e Rahovecit. Ata granatuan fshatin dhe dogjën shtëpi, duke bërë që banorët të iknin. Gjatë sulmit, forcat policore vranë mizorisht një numër burrash, grash dhe fëmijësh të cilët ishin fshehur grupe-grupe në një shtat lumi. Më 25 mars 1999 fshati Krushë e Vogel, në jug të Celinës dhe të Bellacërkës, dhe në veri të Piranës, u rrethua gjithashtu nga forcat e UJ-së dhe të MPB-se. Pastaj MPB-ja hyri në fshat, duke plaçkitur dhe duke djegur shtëpitë me mbështetjen e disa serbëve vendas. Banorët shqiptarë të fshatit u strehuan në një pyll, por u kapën më vonë. Gratë dhe fëmijët u urdhëruan të shkonin në Shqipëri. Më shumë se 110 burrave ua morën sendet me vlerë dhe dokumentat identifikuese. Ata u keqtrajtuuan, dhe pastaj u mbyllën në një hambar dhe u qëlluan me armë zjarri nga anëtarët vendas të policisë. Pas kësaj, hambarit iu vu zjarr. Vetëm tetë persona mbijetuan.

Afërsisht në të njëjtën kohë, banorët e Dushanovës, një lagje e qytetit të Prizrenit, u dëbuan nga shtëpitë e tyre, u rrahën, u kërcënuan, u plaçkitën dhe u dërguan për në Shqipëri. Më vonë, në prill 1999, persona të shpërngulur nga Pirana gjatë operacionit të cilët ishin strehuar në Sërbicën e afërt, u urdhëruan gjithashtu të largoheshin nga fshati dhe të iknin në Shqipëri.

Gjatë operacionit në fund të marsit 1999, forca të posaçme policore ishin dislokuar në qytetin e Suharekës dhe rreth tij. Më 26 mars, personeli vendas i MPB-së shënjestruan anëtarë të familjes Berisha në qytet, duke vrarë 45 burra, gra dhe fëmijë në afërsi të shtëpive të tyre pasi këta të fundit kishin kaluar stacionin e autobusave dhe ishin strehuar në një piceri. Kufomat e shumicës së tyre u gjetën më vonë në një varr masiv në Batajnicë, afër Beogradit. Gjatë ditëve pas vrasjes, u dëmtua xhamia e Suharekës dhe shumë banorë shqiptarë të qytetit të mbetur aty u larguan duke qenë se policia po digjte shtëpitë, vidhte të holla dhe sende me vlerë, dhe i urdhëroi të shkonin në Shqipëri.

Civilë shqiptarë të Kosovës u shpërngulën me dhunë nga fshatrat e komunës së Skenderajt, në Kosovën qendrore, në fund të marsit dhe në prill 1999. Më 26 mars u granatua fshati Turiçefc. Banorët u grumbulluan në një kolonë dhe u larguan në drejtim të Tushillës, në lindje. Pastaj forcat e MPB-se dhe të UJ-së erdhën në Tushillë, dhe u formua një kolonë tjetër e cila filloi të lëvizte në drejtim të Klinës. Rreth asaj kohe, shumë persona të shpërngulur u grumbulluan në një livadh jashtë fshatit Izbicë. Forcat policore rrethuan grupin, urdhëruan gratë dhe fëmijët të shkonin në Shqipëri, dhe mbajtën burrat. Pastaj ata i rreshtuan burrat dhe hapën zjarr mbi ata në dy grupe, duke vrarë të paktën 89 prej tyre.

Rreth mesit të prillit, u dërgua në Çirez një grup grash i mbajtur nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së në fshatin Kozhnicë pasi fshati ishte granatuar. Të paktën katër prej atyre

grave u sulmuan seksualisht dhe tetë prej tyre u vranë, duke u hedhur në tre puse. Në fund të prillit, u zhvillua një ofensivë tjetër rreth Baksit, afër Çirezit. Gjatë këtij sulmi u ndalua dhe u keqtrajtua një grup i madh burrash shqiptarë.

Menjëherë pas fillimit të fushatës të NATO-s, u shënjestruan shqiptarë të njohur të Mitrovicës në veri të krahinës. Disa prej tyre u vranë nga policët. Policia dogji shtëpi të shqiptarëve të Kosovës dhe shumë shqiptarë u dëbuan nga zonat e ndryshme të qytetit. Më vonë, disa prej tyre u kthyen në qytet dhe u larguan përsëri në fillim të prillit për në Malin e Zi me autobus. Në mes të prillit 1999, shumë shqiptarë të Kosovës që jetonin apo që ishin strehuar përkohësisht në Zhabar dhe në fshatra të tjera përreth u detyruan nga forcat e MPB-se dhe të UJ-së, të cilat kishin filluar të digjin shtëpi në fshatra, të formonin kolona dhe të braktisnin Kosovën. Shumë prej këtyre personave u detyruan në shkonin përmes Kosovës në këmbë në drejtim të kufirit të Shqipërisë në jug, dhe u plaçkitën dhe u keqtrajtuat më shumë gjatë rrugës.

Më 27 mars 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-se dogjën shtëpi dhe të paktën një xhami në qytetin e Vushtrrisë dhe dëbuan banorë shqiptarë nga qyteti. Forcat e MPB-se plaçkitën dhe keqtrajtuat shqiptarë të Kosovës në një kolonë të gjatë e cila po lëvizte nga fshatrat e komunës së Vushtrrisë në drejtim të jugut. Gjatë natës së 2 majit 1999, forcat e MPB-se vranë të paktën dy persona në kolonë, e cila u drejtua për në disa ndërtesa të afërta, ku njerëzit u mbajtën gjatë natës. Ditën e nesërme u vra një person tjetër në grup dhe MPB-ja urdhëroi që gratë, fëmijët dhe pleqtë të vazhdonin rrugën për të Shqipëri. Ato mbajtën dhe keqtrajtuat burrat shqiptarë të moshës ushtarake për rreth tri javë në burgun e Smrakonicës, para se t'i detyruan të kalonin kufirin me Shqipërinë.

Në qytetin e Prishtinës, qendra administrative e Kosovës, u përsëritën dëbime të shqiptarëve të Kosovës. Shumë njerëz u dëbuan nga shtëpitë e tyre drejtpërsëdrejti, kursë të tjerë ikën nga frika për shkak të dhunës së shkaktuar nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Dëbimet në Prishtinë u kryen në mënyrë të organizuar, kur qindra shqiptarë të Kosovës u udhëruan të shkonin në stacionin e trenit, dhe u ngarkuan në trena të stërmbushur që i çonin në kufirin me Maqedoni. Gjatë këtij operacioni u sulmuan seksualisht të paktën tri gra shqiptare të Kosovës nga anëtarë të UJ-së dhe të MPB-së.

Fshatarët e Zhegrës dhe të Përlepticës së komunës së Gjilanit u larguan gjithashtu me dhunë nga shtëpitë e tyre. Në Zhegër, në fund të marsit 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së dhe forca të tjera jo të rregullta, duke përfshirë civilë serbë vendas, dëbuan banorët shqiptarë me kërcënime, rrahje dhe vrasje. Shumë persona të shpërngulur kaluan në Maqedoni. Kur u kthyen në shtëpi në fund të konfliktit, panë se shumica e shtëpive të shqiptarëve të Kosovës në fshat ishin djegur dhe dëmtuar në një fare mase, kurse shtëpitë e banorëve serbë ishin të paprekura. Afërsisht në të njëjtën kohë, UJ-ja dhe rezervistët vendas të MPB-së dogjën xhaminë e Llashticës, aty afër, kurse në Lladovë u plaçkitën dhe u dogjën shtëpi, dhe banorët ikën dhe shkuan në Maqedoni, të shoqëruar nga forcat e e MPB-së dhe të UJ-së. Banorët e Përlepticës u urdhëruan të largoheshin nga fshati për herë të parë më 6 prill dhe për herë të dytë më 13 prill 1999.

Në komunën e Ferizajt, në jugperëndim të Gjilanit, gjithashtu u sulmuan fshatra në fund të marsit dhe gjatë prillit 1999. Në Sojevë, UJ-ja, policia dhe persona të tjerë të armatosur që bashkëpunonin me ta, dogjën shtëpi dhe vranë disa njerëz, kurse banorët vendas u detyruan të lëviznin në kolona në drejtim të qytetit të Ferizajt. Disa prej tyre vazhduan rrugën me autobus për në kufirin e Maqedonisë. Në fillim të prillit, rreth 1,000 persona të shpërngulur arritën në Mirosalë. Kur forcat ushtarake iu afruan Mirosalës, banorët dhe të strehuarit e tjerë formuan kolona dhe shkuan në drejtim të qytetit të Ferizajt, duke kaluar pranë automjeteve të shkatërruar dhe shtëpive të djegura. Përfundimisht disa u larguan nga Ferizajt me autobus për në jug dhe kaluan kufirin me Maqedoninë. Gjithashtu në fillim të prillit, forcat e UJ-së morën fshatin Staro Selo. Ata qëndruan aty për disa ditë dhe u larguan duke djegur shtëpi. Pak kohë pas kësaj, një grup

vullnetarësh të UJ-së arritën në fshat, urdhëruan burrat e zonës të hapnin hendekë, konfiskuan makina dhe u morën me zor të holla banorëve. Nga frika banorët u larguan nga shtëpitë dhe shkuan në këmbë në qytetin e Ferizajt. Më vonë, shumë prej tyre hipën në trena të cilët i çuan në kufirin e Maqedonisë.

Së fundi, në komunën e Kaçanikut, në jug të Kosovës pranë Maqedonisë, shqiptarët e Kosovës u dëbuan nga qyteti dhe nga fshatrat përreth që në fillim të fushatës ajrore të NATO-s. Më 24 mars, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan Kotlinën dhe dërguan gratë dhe fëmijët vendas me kamion dhe në këmbë në drejtim të qytetit të Kaçanikut. Fshatarë të tjerë që nuk u kapën, gjatë sulmit ikën në drejtim të Maqedonisë. Disa ditë më vonë, forcat e UJ-së dhe të MPB-së hynë në qytetin e Kaçanikut dhe qëlluan në drejtim të disa shtëpive nga pozicionet në fabrikën vendase. Ditën e nesërme, banorët e kësaj lagjeje të qytetit vendosën të largoheshin nga shtëpitë duke qenë se kishin frikë nga forcat e MPB-së, dhe shkuan me këmbë në Maqedoni. Në prill 1999, njësitë e UJ-së dhe të MPB-së hynë në fshatin Vataj dhe plaçkitën shtëpitë e atjeshme. Më 21 maj 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan Stagovën dhe më 25 maj Dubravën. Banorët e Dubravës vendosën të shkonin në Maqedoni sepse dinin çfarë kishte ndodhur në fshatra të tjera dhe kishin frikë. Gratë, pleqtë dhe fëmijët formuan një kolonë, kurse djemtë e rinj u fshehën në një pyll aty pranë. Gjatë këtij sulmi u qëlluan disa njerëz me armë zjarri afër Rekës së Dubravës, duke përfshirë një vajzë që vdiq dhe një djalë 12-vjeçar që u plagos rëndë.

Përveç provave për vende të caktuara të krimit të përmendura në Aktakuzën, Dhoma dëgjoi dëshmitë që kishin të bënin me mënyrën e përgjithshme të ushtrimit të dhunës dhe të frikësimit të popullatës shqiptare të Kosovës, të paraqitura nga dëshmitarët të cilët kishin qenë anëtarë të forcave të UJ-së dhe të MPB-së në Kosovë në atë kohë. Për shembull, tre ish-anëtarë të UJ-së, të cilët dëshmuuan me masa mbrojtëse, pranuan se kishin marrë pjesë në dëbimin e shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre gjatë fushatës së NATO-s. Dëshmitarë të tjerë të UJ-së dhe të MPB-së treguan për pjesëmarrjen në vrasjen e civilëve shqiptarë të Kosovës dhe në veprime të tjera kriminale.

Nëpërmjet zbatimit të kushteve ligjore të krimeve të pretenduara në Aktakuzë në lidhje me faktet e vërtetuara për secilën prej 13 komunave, Dhoma Gjyqësore konkludon se në shumë vende të përmendura në Aktakuzë forcat e UJ-së dhe MPB-së kryen krimet e dëbimit, krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm), krim kundër njerëzimit; vrasje, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe krim kundër njerëzimit; dhe sulm seksual e shkatërrim pa cak ose dëmtim të objekteve fetare si forma të përndjekjes për arsye etnike. Mirëpo disa pretendime nuk u vërtetuan prej fakteve, ose nuk plotësuan një apo më shumë prej kushteve ligjore, si p.sh ekzekutimi i 17 individëve në Kotlinë më 24 mars 1999 ose rreth kësaj date si dhe shkatërrimi i qëllimshëm i disa xhamive, dhe këto akuza hidhen poshtë. Dhoma gjithashtu thekson se për disa vende krimesh në lidhje me të cilat u ngritën shumë akuza për vrasje dhe emrat e viktimave të pretenduara në Aktakuzë u paraqitën në një Listë, Prokuroria nuk ofroi prova bindëse se faktikisht midis të vdekurve ndodheshin të tëra viktimat e përmendura me emër, megjithëse Dhoma u bind për vërtetësinë e akuzës në lidhje me vrasjen e një grupi të madh njerëzish prej forcave të UJ-së dhe/ose MPB-së.

Tani do të paraqes shkurtimisht përfundimet e Dhomës për çdo të Akuzuar.

Milan Millutinoviqi ishte President i Serbisë gjatë viteve 1998 dhe 1999 dhe shumica e provave të paraqitura prej Prokurorisë dhe Mbrojtjes së tij kishin lidhje me natyrën dhe shtrirjen e pushtetit të tij në këtë funksion. Në Aktgjykim paraqitet analiza prej Dhomës e dispozitave përkatëse të Kushtetutës serbe dhe ligje të tjera përkatëse si dhe dëshmitë në lidhje me këto dispozita. Dhoma konkludon se si president i Serbisë, Millutinoviqi nuk kishte kontroll individual të drejtpërdrejtë mbi UJ-në, institucion federal. Roli i tij formal në lidhje me UJ-në ishte si anëtar ex officio i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes ose KLM në të

cilin bënin pjesë Presidenti i RFJ-së Slobodan Millosheviq, së bashku me Presidentët e Serbisë dhe Malit të Zi dhe ku merreshin vendime strategjike në lidhje me UJ-në. Mirëpo analiza e dokumenteve të mbledhjeve të KLM-së që disponohen si prova nuk tregojnë formulimin ose zbatimin e një plani të përbashkët të pretenduar në Aktakuzë. Për më tepër nuk ka asnjë provë të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të KLM-së pas 23 marsit 1999, në vigjilje të fushatës ajrore të NATO-s, megjithëse Dhoma është e bindur se Millutinoviqi dhe Presidenti i RFJ-së Milosheviqi vazhduan të takoheshin gjatë bombardimeve të NATO-s dhe ende kishin komandë formale mbi UJ-në nëpërmjet KLM-së ose një organi të ngjashëm i njohur si Komanda e Lartë. Mirëpo provat nuk tregojnë se Millutinoviqi ushtroi komandë mbi UJ-në pas 23 marsit 1999. Gjithashtu Dhoma konkludon se në praktikë ishte Millosheviqi, që në disa raste cilësohej "Komandanti i Lartë", ai që ushtroi pushtet komandues faktual mbi UJ-në gjatë fushatës së NATO-s.

Në 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Millutinoviqi mori pjesë në negociatat me përfaqësuesit e shqiptarëve kosovarë dhe ato të ndërmjetësuar prej bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës së Kosovës. Pasi ka analizuar prova të shumta në lidhje me negociatat, Dhoma nuk është e bindur se provat vërtetojnë se Millutinoviqi demonstroi një qasje penguese me synim dështimin e tyre siç argumenton Prokuroria. Gjithashtu provat e paraqitura prej Prokurorisë nuk e bindin Dhomen se Millutinoviqi kishte marrëdhënie të ngushtë personale ose profesionale me Millosheviqin ose se ai kishte një pozitë me ndikim të ndjeshëm në Partinë Socialiste të Serbisë, partia kryesore politike në atë kohë. Këto janë ndërmjet atyre akuzave të Prokurorisë në lidhje me pjesëmarrjen e Millutinoviqit në ngjarjet, të cilat nuk u provuan.

Millutinoviqi mori pjesë në një sërë takimesh në 1998 dhe në fillim të vitit 1999, disa prej tyre të mbajtura në Kosovë, gjatë të cilave u diskutua gjendja në Kosovë. Dhoma konkludon se ai ishte relativisht i mirinformuar në lidhje me rrethanat dhe se ishte në dijeni se forcat e UJ-së dhe MPB-së kishin kryer veprime kriminale në Kosovë në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999, kryesisht nëpërmjet kontakteve të tija me diplomatë, ndërmjetës dhe vëzhgues të huaj. Nga ana tjetër zyrtarë shtetërorë i thanë se problemi i krimeve të kryera në Kosovë ishte trajtuar.

Dhoma Gjyqësore konkludon se si President i Serbisë, Millutinoviqi kishte kompetenca që me gjasë mundësonin mbikëqyrje të konsiderueshme të funksionimit të ministrive të qeverisë serbe, dhe çka është më e rëndësishme edhe Ministrinë e Brendshme. Mirëpo provat nuk vërtetojnë kontakte të shumta midis Millutinoviqit dhe MPB-së në periudhën përkatëse dhe pushteti i tij de facto mbi Ministrinë e Brendshme nuk ishte i qenësishëm. Ai lëshoi disa dekrete gjatë gjendjes së jashtëzakonshme që hyri në fuqi më 23 mars 1999. Mirëpo për arsyet e shtjelluara hollësisht në Aktgjykim, Dhoma nuk është në gjendje të nxjerrë përfundime në dëm të tij prej provave në lidhje me këto dekrete.

Veç pozitës si Zëvendëskryeministër i RFJ-së, Nikolla Shainoviqi ishte Kryetar i Komisionit të RFJ-së për Bashkëpunim me Misionin e Verifikimit në Kosovë të OSBE-së, krijuar pas marrëveshjeve të ndryshme të realizuara në tetor 1998 prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Në Aktakuzë deklarohet se ai ishte përfaqësuesi personal i Presidentit të RFJ-së Millosheviq për Kosovën, dhe se ishte kreu i një organi të quajtur Komanda e Përbashkët e cila kishte pushtet mbi forcat e UJ-së dhe MPB-së të dislokuara në Kosovë në 1998 dhe në fillim të vitit 1999 deri në fund të fushatës ajrore të NATO-s.

Gjatë procesit gjyqësor Prokuroria dhe Mbrojtja i kushtuan kohë të konsiderueshme çështjes së ekzistencës, kompetencave dhe funksionimit të Komandës së Përbashkët. Këto prova diskutohen me hollësi në Vëllimin I të Aktgjykimit. Dhoma konkludon se organi i njohur prej disave si Komandë e Përbashkët në fakt u shfaq në mes të vitit 1998, me synim bashkërendimin e veprimtarisë së UJ-së, MPB-së dhe organeve të

tjera shtetërore të përfshirë në konfliktin e Kosovës. Shënimet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët prej korrikut në tetor të vitit 1998, të pranuar si prova, të mbajtura prej një pjesëmarrësi, ofruan njohuri në lidhje me këtë organ. Këto shënime zbulojnë se Shainoviqi ishte pjesëmarrës aktiv në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, po ashtu si edhe të Akuzuarit Pavkoviç dhe Llukiç dhe në disa raste, Lazareviqi. Në fakt Shainoviqi lëshoi udhëzime në mbledhje, ndër të cilat edhe për çështje në lidhje me veprimtarinë e UJ-së dhe MPB-së. Ekzistojnë prova të drejtpërdrejta vetëm të një mbledhjeje në vitin 1999 në qershor, mirëpo urdhëresat ushtarake u lëshuan me logon e Komandës së Përbashkët, për të mundësuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e forcave të MPB-së dhe UJ-së.

Gjithashtu Shainoviqi mori pjesë në një sërë takimesh të tjera të nivelit të lartë për gjendjen në Kosovë në 1998 dhe 1999 dhe ishte shpesh i pranishëm në Kosovë si në 1998 po ashtu edhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Presidenti i RFJ-së Millosheviç ishte përcaktues në dërgimin e tij në Kosovë prej verës së vitit 1998 dhe në emërimin e tij si Kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me Misionin e Verifikimit në Kosovë në tetor 1998, fakt që i mundësoi atij mbajtjen e kontakteve me personelin e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë si dhe me vëzhguesit ndërkombëtarë të atjeshëm. Rrjedhimisht vazhduan pa ndërprerje kontaktet e tij me të Akuzuarin Pavkoviç të UJ-së dhe Llukiçin e MPB-së dhe ndikimi i tij ndaj tyre.

Shainoviqi u takua shpesh me Millosheviçin gjatë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 si dhe bisedoi shpesh në telefon me të dhe një sërë dëshmitarësh dëshmuan për natyrën e marrëdhënieve të tyre. Mbi bazën e këtyre provave, Dhoma konkludon se Shainoviqi ishte një nga ndihmësit më të afërt dhe më të besuar të Millosheviçit, faktor që e ndihmoi atë në marrjen e një roli kryesor në Komandën e Përbashkët dhe në Komisionin për Bashkëpunimin me MVK-në. Ai ishte zyrtar me pozitë të fuqishme në qeverinë e RFJ-së, i cili jo vetëm i përcillte informacion Millosheviçit dhe përcillte udhëzimet e Millosheviçit për zyrtarët e Kosovës, por kishte edhe ndikim të madh mbi ngjarjet në krahinë dhe kishte kompetencë për marrjen e vendimeve.

Shainoviqi u takua me ish-udhëheqësin e atëhershëm politik shqiptar kosovar Ibrahim Rugovë gjatë fushatës ajrore të NATO-s, gjatë periudhës kur Rugovë efektivisht ishte në arrest shtëpie. Dhoma nuk i konsideron këto takime si përpjekje e njëmendtë për gjetjen e një zgjidhjeje për Kosovën, por si fushatë ku u përfshinë edhe kërcënime ndaj sigurisë individuale të Rugovës, e projektuar për të treguar se autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë po bisedonin me shqiptarët e Kosovës me shpresë se kështu do të ndërpriteshin bombardimet e NATO-s. Shainoviqi mori pjesë me vetëdije dhe qëllimisht në këtë fushatë.

Gjithashtu Dhoma konstaton se Shainoviqi ishte i mirinformuar për ngjarjet në Kosovë si për vitin 1998 po ashtu edhe për 1999 dhe se ishte në dijeni për kryerjen e veprimeve kriminale të forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, përfshirë edhe periudhën gjatë bombardimeve të NATO-s. Shainoviqi nuk ushtroi pushtetin e tij të gjerë në Kosovë dhe iniciativën e tij për të mundësuar ndërprerjen e sjelljes kriminale.

Dragolub Ojdaniqi u bë Shef i Shtabit të Përgjithshëm, pozita më e lartë në UJ, në fund të vitit 1998, duke zëvendësuar Momçillo Perishiçin i cili u hoq prej Millosheviçit. Para kësaj ngritjeje në pozitë, ai kishte qenë Zëvendës-shef i Shtabit të Përgjithshëm. Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi varej vetëm prej autoritetve civile të cilat ishin mveshur me komandën e përgjithshme të UJ-së, gjegjësisht Këshilli i Lartë i Mbrojtjes. Dhoma është e bindur se si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi ushtroi komandë dhe kontroll mbi të gjitha njësitë dhe organet e UJ-së. Ai bashkëpunoi ngushtë me Presidentin e RFJ-së para dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s dhe ushtroi pushtet de facto dhe de jure mbi UJ-në. Gjithsesi ai nuk kishte kontroll të drejtpërdrejtë mbi forcat e MPB-së të

angazhuara në Kosovë, pavarësisht urdhëresave për rivendosjen e vartësisës së MPB-së ndaj UJ-së lëshuar në prill 1999.

Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi mori pjesë në mbledhjet e KLM-së dhe ishte pjesëmarrës aktiv në diskutime. Provat nuk vërtetojnë se ai mori pjesë në organin e quajtur Komanda e Përbashkët por ishte në dijeni dhe e pranoi funksionimin e saj. Dhoma konkludon se Ojdaniqi ishte në dijeni dhe miratoi shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit, të cilat ndodhën në fund të vitit 1998 dhe fillim të vitit 1999. Gjithashtu ai ishte në dijeni të përfshirjes së UJ-së në armatosjen e popullatës civile joshqiptare në Kosovë. Po ashtu ai përkrahu emërimin e personelit të UJ-së në pozita të larta, të cilët ose mbështetën veprimtarinë e UJ-së në Kosovë si i Akuzuari Pavkoviç, ose thjesht nuk ngritën asnjë kundërshtim në lidhje me të, dhe ishte në dijeni të largimit nga detyra të oficerëve të lartë të UJ-së të cilët kundërshtuan përdorimin e UJ-së në Kosovë.

Deri në fillimin e fushatës ajrore të NATO-s dhe gjatë saj, Ojdaniqi lëshoi urdhëresa drejtuar UJ-së për kryerjen e operacioneve anëmbanë Kosovës, ndër të cilat edhe ndihmesa ndaj MPB-së Gjithashtu ai mobilizoi njësi shtesë të UJ-së për dislokim në Kosovë gjatë periudhës kur ndodhi shumica e krimeve të vërtetuara prej Dhomës.

Nëpërmjet sistemit raportues të UJ-së, Ojdaniqi u mbajt i mirinformuar përditë në lidhje me gjendjen në terren në Kosovë, para dhe gjatë bombardimeve të NATO-s. Në vitet 1998 dhe 1999 atij iu përcoll informacion konkret për përdorimin e tepruar ose pa dallim të forcës prej njërive të UJ-së dhe MPB-së. Ai ishte gjithashtu në dijeni se vullnetarët e përfshirë në radhët e UJ-së gjatë bombardimeve të NATO-s kishin marrë pjesë në kryerjen e veprimeve kriminale. Në fakt ai ndërmori disa hapa si reagim ndaj raporteve që merrte, si p.sh lëshimi i urdhëresave për respektimin e normave të së drejtës humanitare ndërkombëtare, aktivizimi i sistemit të drejtësisë ushtarake, dhe dërgimi i oficerëve të lartë prej Administratës së Sigurimit për hetime. Gjithsesi ai vazhdoi të urdhëronte pjesëmarrjen e UJ-së në operacione ushtarake në Kosovë së bashku me MPB-në.

Në vitin 1998 Nebojsa Pavkoviç ishte Komandant i Korpusit të Prishtinës të UJ-së, që kishte përgjegjësi për territorin e Kosovës. Në fund të atij viti ai u bë Komandant i Armatës së Tretë që përfshinte Korpusin e Prishtinës dhe Korpusin e Nishit. Në të dy funksionet ai kishte kontroll de jure dhe de facto mbi njësitë në varësi të tij, dhe luajti rol qendror në planifikimin dhe zbatimin e veprimtarisë së UJ-së në Kosovë në bashkërendim me MPB-në. Në fakt Dhoma dëgjoji dëshmi bindëse se në vitin 1998 ai mbështeti idenë për një rol më të madh të UJ-së në Kosovë dhe u vu në krye të propozimeve për veprime konkrete të UJ-së dhe MPB-së. Ai kishte kontakt të drejtpërdrejtë me Presidentin e RFJ-së, Millosheviç, i cili i përkrahu dhe miratoi propozimet e tij, me gjithë protestat prej të tjerëve në UJ. Gjatë kohës si Komandant i Korpusit të Prishtinës, Pavkoviç u konfliktua me eprorin e tij të drejtpërdrejtë, Komandantin e atëhershëm të Armatës së Tretë dhe pa dyshim kishte mosmarrëveshje me Shefin e atëhershëm të Shtabit të Përgjithshëm në lidhje me përdorimin e UJ-së në Kosovë, të cilët u hoqën që të dy nga detyra dhe Pavkoviç u bë Komandant i Armatës së Tretë.

Dhoma konstaton se në vitin 1998, Pavkoviç u përfshi në armatosjen e popullatës civile joshqiptare në Kosovë dhe njëkohësisht çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë, megjithëse ishte në dijeni të ndasisë dhe armiçësisë etnike në Kosovë.

Si Komandant i Korpusit të Prishtinës në 1998, Pavkoviç lëshoi urdhëresa të shumta për dislokimin e njërive të UJ-së shpesh në operacione të përbashkëta me MPB-në. Ai u informua mbi pretendimet për përdorimin e tepruar dhe pa dallim të forcës prej UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, ndër të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes së tij të shpeshtë në

mbledhjet e Komandës së Përbashkët ku u diskutua hollësisht gjendja në Kosovë, dhe megjithatë vazhdoi t'i hidhte në veprim njësitë e tij.

Dhoma gjithashtu konstaton se si komandant i Korpusit të Prishtinës dhe më tej si Komandant i Armatës së Tretë, Pavkoviqi u përfshi drejtpërsëdrejti në shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999. Sapo u bë Komandant i Armatës së Tretë, ai pruri njësi shtesë në Kosovë për zgjerimin e UJ-së, në kundërshtim me Marrëveshjet dhe dërgoi një brigadë të posaçme në brendësi të Kosovës në kundërshtim të një udhëzimi të drejtpërdrejtë të Ojdaniqit.

Deri në fillimin e fushatës ajrore të NATO-s dhe gjatë saj, si Komandanti i Armatës së Tretë, Pavkoviqi vazhdoi të lëshonte urdhëresa për kryerjen e operacioneve prej njësite të UJ-së në Kosovë, ndër të tjera edhe në zona ku Dhoma ka vërtetuar kryerjen e krimeve prej forcave të UJ-së dhe MPB-së. Gjithashtu ai vazhdoi të bashkëpunonte ngushtë me Presidentin e RFJ-së Millosheviq në këtë periudhë. Gjithsesi ai nuk kishte kontroll të drejtpërdrejtë mbi forcat e MPB-së të angazhuara në Kosovë, pavarësisht urdhëresave për rivendosjen e vartësisë së MPB-së ndaj UJ-së lëshuar në prill 1999.

Në 1998 dhe 1999, Pavkoviqi më të shumtën e kohës ishte i pranishëm në Kosovë. Nëpërmjet pranisë së tij në Komandën e Përbashkët dhe në mbledhje të tjera në 1998, sistemit të rregullt raportues të UJ-së dhe inspektimeve të tija në njësitë e UJ-së dislokuar anembanë Kosovës, ai kishte njohuri të hollësishme dhe një ide të plotë të gjendjes në terren dhe të veprimeve të forcave të tija dhe të MPB-së. Këto njohuri përfshinin edhe kryerjen e krimeve prej forcave të UJ-së dhe MPB-së, ndër të cilat shpërngulja me dhunë të shqiptarëve të Kosovës, vrasjet dhe sulmet seksuale ndaj tyre. Në fakt Dhoma konstaton se megjithëse Pavkoviqi dinte për veprime kriminale të kryera prej pjesëtarve të UJ-së në Kosovë, në disa raste ai raportoi fare pak dhe minimizoi veprat e rënda kriminale në raportet e tij dërguar Shtabit të Komandës së Lartë. Megjithëse ai lëshoi disa urdhëresa për respektimin e normave të së drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë kryerjes së këtyre operacioneve, Dhoma nuk gjykon se këto ishin masa të njëmendëta për kufizimin e kryerjes së krimeve në Kosovë.

Kur Pavkoviqi u bë Komandant i Armatës së Tretë në fund të vitit 1998, ish-Shefi i Shtabit të tij në Korpusin e Prishtinës, Vladimir Lazareviqi u emërua në vend të tij si Komandant i Korpusit të Prishtinës. Gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve Lazareviqi ishte i bazuar në Kosovë, fillimisht në Gjakovë dhe më vonë në Prishtinë dhe rreth saj. Një prej detyrave të tij si Shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës ishte monitorimi i kufirit shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Gjithashtu ai kontribuoi në zbatimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në atë zonë në gjysmën e dytë të vitit 1998.

Dhoma konkludon se në vitin 1998 Lazareviqi ishte në dijeni të faktit se në Kosovë po kryheshin veprime kriminale kundër civilëve dhe pronave të civilëve gjatë operacioneve të UJ-së dhe MPB-së. Gjithashtu ai dinte se kjo shkaktoi shpërnguljen e një numri të madh civilësh.

Pas emërimit të tij si komandant i Korpusit të Prishtinës, Lazareviqi kishte kontroll de jure dhe de facto mbi njësitë në varësi të tij, ndër të cilat njësitë e rregullta të UJ-së dhe prej fillimit të prillit 1999, repartet ushtarake territoriale. Ai nuk kishte kontroll të drejtpërdrejtë mbi njësitë e MPB-së të angazhuara në Kosovë. Provat vërtetojnë se pjesëmarrja e Lazareviqit në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së të kryera prej marsit në qershor 1999 në Kosovë ishte e konsiderueshme, përfshirë edhe vendet për të cilat Dhoma ka vërtetuar kryerjen e krimeve. Ai vazhdoi të vepronte në këtë mënyrë, me gjithë dijeninë e tij për kryerjen e krimeve të tilla. Mirëpo në ndryshim nga Pavkoviqi, Lazareviqi nuk u përfshi ose jo domosdoshmërisht ishte në dijeni të tërë procesit të vendimmarrjes politike në Beograd dhe nuk mori pjesë në mbledhjet e nivelit të lartë atje.

Thelbi i ballafaqimit gjatë procesit gjyqësor në lidhje me pretendimin për përgjegjësinë penale të Sreten Llukiqit u përqëndrua mbi natyrën dhe kompetencat e organit të quajtur Shtabi i MPB-së për Kosovën, kreu i të cilit ishte Llukiqi. Mbrojtja e Llukiqit solli një sërë dëshmitarësh të cilët dëshmuar se Shtabi i MPB-së kishte detyra logjistike dhe aspak kompetenca apo pushtet të vërtetë mbi forcat e MPB-së të dislokuara në Kosovë në 1998 dhe 1999. Këto dëshmi ndryshojnë shumë prej përmbajtjes së vendimeve themeluese të këtij organi ku përcaktohen detyrat e tij, si dhe prej shumë provave të tjera dokumentare ku zbulohet roli i luajtur prej Shtabit të MPB-së në vitin 1998 dhe gjysmën e parë të vitit 1999. Disa dëshmitarë gjithashtu i atribuon një masë më të madhe përgjegjësie Shtabit të MPB-së dhe Llukiqit në krye për forcat e ndryshme të MPB-së në Kosovë, krahasuar me parashtrimet e Mbrojtjes së Llukiqit.

Në Aktgjykim Dhoma shtjellon në hollësi analizën e saj të të gjitha provave në lidhje me Shtabin e MPB-së dhe konstaton se në të vërtetë ai kishte një rol të qenësishëm në planifikimin, organizimin, kontrollimin dhe drejtimin e operacioneve të forcave të ndryshme të MPB-së në Kosovë. Dhoma është e bindur se Shtabi i MPB-së ishte organ kyç në 1998 dhe 1999, me pushtet të konsiderueshëm mbi njësitë në varësi të Departamentit të Sigurisë Publike të MPB-së, ndër të cilat njësitë e policisë speciale kur u dislokuan në Kosovë, megjithëse nuk zëvendësoi linjën komanduese brenda njërive dhe sekretariateve të ndryshme brenda MPB-së. Shtabi i MPB-së bashkëpunoi me UJ-në për të mundësuar bashkërendim të plotë të veprimtarisë së MPB-së dhe UJ-së në Kosovë, dhe kishte rol të rëndësishëm në planifikimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së. Gjithashtu ai shërbeu si urë lidhëse për selinë e MPB-së në Beograd ku raportonte rregullisht.

Dhoma është e bindur se si kreu i Shtabit të Përgjithshëm të MPB-së, Llukiqi ishte mveshur me pushtet të konsiderueshëm mbi forcat e MPB-së që përgjigjeshin para Shtabit të MPB-së. Në fakt diplomatët dhe vëzhguesit e huaj me të cilat ai pati kontakte dhe takime në Kosovë, në emër të MPB, kuptuan se ai ishte komandant i forcave të MPB-së në Kosovë. Gjithashtu ai mori pjesë rregullisht në mbledhje të nivelit të lartë të Komandës së Përbashkët dhe mbledhje të tjera të nivelit të lartë në Beograd. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se Llukiqi ishte komandant de facto i forcave të MPB-së në Kosovë prej mesit të vitit 1998 deri në mes të vitit 1999, si edhe hallkë lidhëse midis operacioneve në terren të forcave të MPB-së në Kosovë dhe politikave e planeve të përgjithshme të vendosura në Beograd.

Provat vërtetojnë se Llukiqi kishte njohuri të hollësishme të ngjarjeve në Kosovë, gjatë zhvillimit të tyre, si dhe u informua në lidhje me pretendimet për sjellje kriminale të personelit të MPB-së atje. Mirëpo Dhoma nuk është e bindur prej provave të paraqitura se Llukiqi mori pjesë në fshehjen e këtyre krimeve nëpërmjet transportimit klandestin të kufomave të civilëve nga Kosova në pjesë të tjera të Serbisë.

Pas përshkrimit përmbledhës të përfundimeve të Dhomës për çdo të Akuzuar, tani do të shqyrtoj përfundimet tona në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale të shtjelluara në Aktakuzë dhe pretendimit për pjesëmarrjen e të Akuzuarve në të.

Provat më bindëse në mbështetje të pretendimit për ekzistencën e një synimi të përbashkët për ndryshimin e balancës etnike në Kosovë për garantimin e vazhdimësisë së kontrollit të krahinës prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë janë provat që vërtetojnë fushatën e përhapur gjerësisht të dhunës kundër popullatës shqiptare kosovare në periudhën mars - qershor 1999, me pasojë shpërnguljen masive të kësaj popullate. Kjo fushatë u krye në mënyrë të organizuar, duke shfrytëzuar burime të konsiderueshme shtetërore dhe Dhoma dëgjoi dëshmi nga dëshmitarë të shumë në lidhje me faktin se ata u udhëzuan të largoheshin prej Kosovës për në Shqipëri dhe Maqedoni dhe se u detyruan

të dorëzonin dokumentet personale identifikuese, ose në nisje, gjatë rrugëtimit ose në kufi. Këto dokumente nuk iu kthyen kurrë.

Në nxjerrjen e konkluzionit për ekzistencën e një synimi të përbashkët për përdorimin e dhunës dhe terrorit për dëbimin e një numri të madh shqiptarësh kosovarë prej shtëpive të tyre, përtej kufijve me qëllim vazhdimësinë e kontrollit shtetëror në Kosovë, Dhoma mori parasysh edhe faktorë të tjerë si: ngjarjet që çuan në konflikt; armatosja e popullatës civile joshqiptare në Kosovë dhe njëkohësisht çarmatosja e shqiptarëve kosovarë; dështimi i negociatave për dhënien fund të krizës në Kosovë në të njëjtën kohë me kryerjen e shkeljeve të Marrëveshjeve të Tetorit prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë; dhe fshehja e kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë prej forcave të UJ-së dhe MPB-së. Mirëpo Dhoma nuk është e bindur se vrasjet, sulmet seksuale ose shkatërrimi apo dëmtimi i objekteve fetare përfshiheshin në synimin e përbashkët, dhe merr në konsideratë vetëm opsionin nëse këto krime ishin normalisht të parashikueshme në zbatimin e synimit të përbashkët në lidhje me çdo të Akuzuar.

Pasi është bindur për ekzistencën e synimit të përbashkët midis zyrtarëve të lartë në RFJ dhe Serbi, të cilët ishin në gjendje ta vinin në jetë nëpërmjet forcave të ndryshme nën kontrollin e tyre, Dhoma ka analizuar nëse çdo i Akuzuar mori pjesë vullnetarisht në ndërmarrjen e përbashkët krimale, dha kontribut të konsiderueshëm, dhe kishte synim të përbashkët për kryerjen e krimeve ose veprave penale që ishin objekt i këtij plani.

Dhoma nuk është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Milan Millutinoviçi dha kontribut të konsiderueshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Dhoma nuk pranon se Milan Millutinoviçi kishte detyrë ligjore të vepronte për parandalimin e ngjarjeve që ndodhën në Kosovë, vetëm prej betimit të tij për funksionin, pa patur kompetenca të qenësishme de facto dhe de jure. Gjithashtu Dhoma nuk pranon se ai kontribuoi konsiderueshëm nëpërmjet mosveprimit, duke marrë parasysh mungesën e pushtetit të Millutinoviçit ndaj forcave që kryen krimet në fjalë. Për më tepër, Dhoma nuk është e bindur se Millutinoviçi kishte synim të përbashkët për përdorimin e metodave kriminale, gjegjësisht dëbimin dhe transferimin e dhunshëm për mbajtjen e kontrollit të shtetit në Kosovë.

Dhoma është e bindur se Nikolla Shainoviçi kishte pushtet të konsiderueshëm de facto mbi MPB-në dhe UJ-në që vepronin në Kosovë, dhe se ai ishte bashkërenduesi politik i këtyre forcave. Ajo është e bindur se ai dha kontribut të ndjeshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se në fakt ishte një prej anëtarëve më të rëndësishëm të ndërmarrjes së përbashkët. Bazuar në të tëra provat, Dhoma konkludon se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se Shainoviçi kishte synim shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare, si brenda Kosovës, po ashtu dhe jashtë saj dhe nëpërmjet kësaj ndryshimin e balancës etnike në krahinë dhe garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror. Gjithashtu Dhoma konkludon se vrasja e civilëve shqiptarë kosovarë prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në zbatim të planit të përbashkët kriminal si edhe shkatërrimi apo dëmtimi i objekteve fetare, konkretisht xhamive, ishin logjikisht të parashikueshme për Shainoviçin. Mirëpo shumica e Dhomës nuk gjykon se kryerja e sulmeve seksuale ishte e parashikueshme për të.

Dhoma konkludon se megjithëse disponohen prova të konsiderueshme në mbështetje të akuzës së Prokurorisë se Dragolub Ojdaniçi ishte mbështetës i kryerjes së krimeve anëmbanë Kosovës prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në një sulm të gjerë dhe sistematik kundër shqiptarëve kosovarë, nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte synim garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror mbi krahinën nëpërmjet dëbimeve dhe transferimit të dhunshëm të një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare. Mirëpo Dhoma konkludon se me veprimet e tija në vazhdimësi në komandë të forcave të UJ-së në varësi të tij, Ojdaniçi dha ndihmesë praktike, inkurajim ose përkrahje morale ndaj anëtarëve të UJ-së për të

cilët ai dinte se synonin të kryenin dëbim dhe transferim të dhunshëm. Sjellja e tij ushtroi ndikim të konsiderueshëm në kryerjen aktuale të këtyre krimeve prej forcave të UJ-së në disa vendndodhje të përmendura në Aktakuzë. Mirëpo Dhoma konkludon se Ojdaniqi nuk kishte dijeni se forcat e UJ-së synonin të vrisnin ose sulmonin seksualisht civilët shqiptarë kosovarë, ose dëmtonin apo shkatërronin objekte fetare.

Dhoma ka konstatuar se Nebojsa Pavkoviqi kishte pushtet të qenësishëm komandues de jure dhe de facto mbi forcat e UJ-së në Kosovë në 1998 dhe 1999 dhe kishte një pozitë ndikuese, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tij në Komandën e Përbashkët. Nuk ka dyshim se kontributi i tij në ndërmarrjen e përbashkët kriminale ishte i konsiderueshëm, duke qenë se ai përdori forcat e UJ-së në dispozicion të tij për të terrorizuar dhe përzënë me dhunë civilët shqiptarë kosovarë prej shtëpive të tyre. Gjithashtu Dhoma konkludon se përfundimi i vetëm i logjikshëm prej të tëra provave është se Pavkoviqi kishte synim shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare për të garantuar vazhdimësinë e kontrollit shtetëror mbi krahinën. Për më tepër, Dhoma gjykon se në ato rrethana, kryerja e vrasjeve, sulmeve seksuale dhe shkatërrimi ose dëmtimi i qëllimshëm i xhamive prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në zbatim të urdhrave të tij, ishin logjikisht të parashikueshme për Pavkoviqin.

Dhoma konkludon se megjithëse ekzistojnë prova të konsiderueshme në mbështetje të akuzës së Prokurorisë se Vladimir Llazareviqi ishte mbështetës i kryerjes së krimeve anëmbanë Kosovës prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në një sulm të gjerë dhe sistematik kundër shqiptarëve kosovarë, nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte synim garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror mbi krahinën nëpërmjet dëbimeve dhe transferimit të dhunshëm të një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare. Mirëpo Dhoma konkludon se me veprimet e tija në vazhdimësi në komandë të forcave të UJ-së në varësi të tij, Llazareviqi dha ndihmë praktike, inkurajim ose përkrahje morale ndaj anëtarëve të UJ-së për të cilët ai dinte se synonin të kryenin dëbim dhe transferim të dhunshëm. Sjellja e tij ushtroi ndikim të konsiderueshëm në kryerjen aktuale të këtyre krimeve prej forcave të UJ-së në disa vendndodhje të përmendura në Aktakuzë. Mirëpo Dhoma konkludon se Llazareviqi nuk kishte dijeni se forcat e UJ-së synonin të vrisnin ose sulmonin seksualisht civilët shqiptarë kosovarë, ose dëmtonin apo shkatërronin objekte fetare.

Dhoma ka konkluduar se Sretën Llukiqi kishte pushtet të qenësishëm mbi njësitë e MPB-së të dislokuara në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999 dhe se ishte përgjegjës për planifikimin, organizimin, kontrollimin dhe drejtimin e veprimtarisë së MPB-së në krahinë. Gjithashtu ai bashkëpunoi ngushtë me udhëheqjen e UJ-së dhe instancave të tjera shtetërore dhe mori pjesë në mbledhje të nivelit të lartë për diskutimin e gjendjes në Kosovë. Bazuar në të tëra provat, Dhoma konkludon se Llukiqi ishte në fakt pjesëmarrës i rëndësishëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe dha kontribut të ndjeshëm nëpërmjet kontrollit prej tij të forcave të MPB-së të përfshira në zbatimin e planit. Gjithashtu Dhoma konkludon se i vetmi përfundim logjik është se Llukiqi kishte synim shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare për garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror mbi krahinën. Më tej konkludohet se vrasjet e civilëve shqiptarë kosovarë prej forcave të UJ-së dhe MPB-së që zbatonin planin e përbashkët si dhe shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve fetare, si xhamitë, ishin logjikisht të parashikueshme për Llukiqin. Mirëpo shumica e Dhomës nuk konkludon se kryerja e sulmeve seksuale ishte e parashikueshme për të.

Gjykatësi Chowhan ka mendim mospajtues në lidhje me parashikueshmërinë e sulmeve seksuale përsa u përket Shainoviqit dhe Llukiqit.

I Akuzuari Millutinoviç, ngrihuni, ju lutem.

Për të gjitha arsyet që përmbloodha, Dhoma Gjyqësore ju shpall juve, Millan Millutinoviq, TË PAFAJSHËM, sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) të Statutit, për pikat 1 deri 5 të Aktakuzës. Sipas Rregullës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirim tuaj të menjëhershëm prej Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara, pas përfundimit të formaliteteve të nevojshme, pa marrë parasysh ndonjë procedurë gjyqësore tjetër që mund të pasojë pas vendimit të Dhomës Gjyqësore III sipas paragrafit të fundit të Aktgjykimit në lidhje me të tre vendet e mbetur të krimit në Aktakuzë.

I Akuzuari Shainoviq, ngrihuni, ju lutem.

Për të gjitha arsyet që përmbloodha, Dhoma Gjyqësore ju shpall juve, Nikolla Shainoviq, FAJTOR për pikat 1 deri 5 të Aktakuzës, sipas Nenit 7(1) të Statutit. Dhoma Gjyqësore ju jep një dënim të vetëm prej 22 vitesh burgim, duke llogaritur kohën që keni kaluar në paraburgim. Sipas Rregullës 103(C) të Rregullores, do të mbeteni në paraburgim të Tribunalit deri në përfundimin e formaliteteve për transferimin tuaj në shtetin ku do të vuani dënimin.

I Akuzuari Ojdaniq, ngrihuni, ju lutem.

Për të gjitha arsyet që përmbloodha, Dhoma Gjyqësore ju shpall juve, Dragolub Ojdaniq, FAJTOR për pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, sipas Nenit 7(1) të Statutit, dhe TË PAFAJSHËM për pikat 3 deri 5 të Aktakuzës, sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) të Statutit. Dhoma Gjyqësore ju jep një dënim të vetëm prej 15 vitesh burgim, duke llogaritur kohën që keni kaluar në paraburgim. Sipas Rregullës 103(C) të Rregullores, do të mbeteni në paraburgim të Tribunalit deri në përfundimin e formaliteteve për transferimin tuaj në shtetin ku do të vuani dënimin.

I Akuzuari Pavković, ngrihuni, ju lutem.

Për të gjitha arsyet që përmbloodha, Dhoma Gjyqësore ju shpall juve, Nebojsa Pavković, FAJTOR për pikat 1 deri 5 të Aktakuzës, sipas Nenit 7(1) të Statutit. Dhoma Gjyqësore ju jep një dënim të vetëm prej 22 vitesh burgim, duke llogaritur kohën që keni kaluar në paraburgim. Sipas Rregullës 103(C) të Rregullores, do të mbeteni në paraburgim të Tribunalit deri në përfundimin e formaliteteve për transferimin tuaj në shtetin ku do të vuani dënimin.

I Akuzuari Llazareviq, ngrihuni, ju lutem.

Për të gjitha arsyet që përmbloodha, Dhoma Gjyqësore ju shpall juve, Vladimir Llazareviq, FAJTOR për pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, sipas Nenit 7(1) të Statutit, dhe TË PAFAJSHËM për pikat 3 deri 5 të Aktakuzës, sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) të Statutit. Dhoma Gjyqësore ju jep një dënim të vetëm prej 15 vitesh burgim, duke llogaritur kohën që keni kaluar në paraburgim. Sipas Rregullës 103(C) të Rregullores, do të mbeteni në paraburgim të Tribunalit deri në përfundimin e formaliteteve për transferimin tuaj në shtetin ku do të vuani dënimin.

I Akuzuari Llukiq, ngrihuni, ju lutem.

Për të gjitha arsyet që përmbloodha, Dhoma Gjyqësore ju shpall juve, Sreten Llukiq, FAJTOR për pikat 1 deri 5 të Aktakuzës, sipas Nenit 7(1) të Statutit. Dhoma Gjyqësore ju jep një dënim të vetëm prej 22 vitesh burgim, duke llogaritur kohën që keni kaluar në paraburgim. Sipas Rregullës 103(C) të Rregullores, do të mbeteni në paraburgim të Tribunalit deri në përfundimin e formaliteteve për transferimin tuaj në shtetin ku do të vuani dënimin.

Seanca mbyllet.